



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:069107

Datë: 16.12.2023

Numri i dokumentit: 05078127

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.242/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurit M. I. , i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.548/22 të datës 06.04.2022 për shkak të veprës penale „Vjedhje” e mbetur në tentativë nga neni 313 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 04.12.2023 në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku te pandehurit M. I. , me datë 04.12.2023 shpalli, ndërsa me datë 15.12.2023 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

M. I. i atësisë I.dhe amësisë T., e vajzërisë K., i lindur me dt. në fsh.S.i E., K. Deçan, rr, „B. Q. I.”, nr.31, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i një vajze, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 27.03.2022 rreth orës 14:15 min, në rrugën „Z. P.”në Pejë, përkatësisht në Qendrën Tregtare V. F., me dashje dhe me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten tenton t’ia merr pasurinë e luajtshme personit tjetër dhe atë të dëmtuarit I.H. në atë

mënyre që derisa i dëmtuari ndodhet brenda qendrës tregtare aty kishte marrë një palë pantolla të cilat paraprakisht kishte hyrë për t'i provuar brenda zveshtores dhe aty brenda kishte lënë xhaketën e varur dhe kishte dal jashtë, aty vjen i pandehuri i cili e pyet të dëmtuarin se a mundet të futet brenda zveshtores dhe kur i dëmtuari i thotë se po, ai futet brenda dhe aty pasi sheh xhaketën e të dëmtuarit të varur fut dorën në xhepin e sak dhe nga aty merr portofolin dhe telefonin celularë dhe del jashtë duke u nisur për t'u larguar, mirëpo i dëmtuari e heton dhe i kërkon që të ndalohet dhe me pas të njëjtin e pyet lidhur me gjësendet personale për të cilat i pandehuri e pranon se i ka marrë dhe aty i'a kthen të dëmtuarit.

- me çka ka kryer veprë penale „Vjedhje” e mbetur në tentativë nga neni 313 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së,

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit M. I. i shqipton:

I. DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro si dhe DENIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, të cilat dënime KUSHTËZOHEN, nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

III. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike eventuale, udhëzohet në kontest të rregullt civil-juridik.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 06.04.2022, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.548/22 kundër të pandehurit M. I. , për shkak të veprës penale „Vjedhje” e mbetur në tentativë nga neni 313 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 04.12.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri M. I. , në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “Meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë në mënyrë vullnetare dhe duke e kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e po ashtu pranimi i fajit e beri duke u mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga Gjykata kërkoi që të pandehurin ta shpallë fajtorë ta dënoi sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoi si rrethanë lehtësuese”.

Pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, i pandehuri M. I. deklaroi “i kërkoi shumë falje gjykatës, ndihem i penduar për këtë veprim”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim deri në tri (3) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro, dhe dënim

me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 dhe 43 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për vepër penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë kumulative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Po ashtu gjykata të pandehurit i shqiptoj edhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimeve gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit M. I. do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim dhe gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet

“Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e ne këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale me te rendë që është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim deri në tri (3) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil, për kërkesat eventuale u mor në përputhje me nenin 462 par. 2, të KPRK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.242/21, me datë 15.12.2023

Bashkëpunëtorja profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.